



Në bazë të Ligjit Nr. 08/L – 197 për zyrtarët publikë, Neni 39 (1,2,3,4,5 dhe 6) dhe Rregullores (QRK) NR. 15/2023 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 5 Agjencia Kosovare e Privatizimit shpall:

## Konkurs

### Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

<b>Titulli i pozitës së punës</b>	Zëvendës drejtor - Operativ
<b>Klasa e pozitës</b>	Drejtues i Lartë 3
<b>Koeficienti/Paga</b>	1-4
<b>Nr. i kërkuar</b>	1
<b>Data e njoftimit</b>	19/01/2024
<b>Afati për aplikim</b>	20/01/2024 - 18/02/2024
<b>Institucioni</b>	Agjencia Kosovare e Privatizimit
<b>Departamenti</b>	Agjencia Kosovare e Privatizimit
<b>Divizioni</b>	Agjencia Kosovare e Privatizimit
<b>Vendi i punës</b>	Prishtinë
<b>Nr. i Referencës</b>	RN00013130
<b>Kodi</b>	RPC0006669



## 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

---

- Ndhmon Drejtorin Ekzekutiv në zbatimin e vendimeve dhe udhëzimeve të Bordit të Drejtorëve duke u koordinuar ngushtë me Drejtorët/Udhëheqësit e Departamenteve përkatëse të AKP-së;
- Ndhmon Drejtorin Ekzekutiv në koordinimin e punëve lidhur me zhvillimin e strategjive të shitjes, përfshirë këtu shitjet direkte si dhe metodat tjera alternative të transformimeve si dhe likuidimit, oraret dhe mënyrat për të maksimizuar interesimin në shitjen e aseteve të tyre brenda afatit kohor më të shkurtër të mundshëm brenda kornizës ligjore të aplikueshme dhe ekzekutimin e procesit të likuidimit/shitjes brenda afatit kohor më të shkurtër;
- Nën mbikqyrjen e Drejtorit Ekzekutiv hulumton zhvillimin e mënyrave alternative për të trajtuar/privatizuar asetet problematike dhe çështjet që preokupojnë procesin e likuidimit;
- E ndihmon Drejtorin Ekzekutiv në përgatitjen e informatave dhe propozimeve për Bordin e Drejtorëve;
- Nën mbikqyrjen e Drejtorit Ekzekutiv kryen të gjitha përgjegjësitë dhe funksionet që dalin nga procesi i likuidimit sipas shtojcës së Ligjit të AKP-së duke përfshirë edhe përgjegjësitë nga mbikëqyrja/koordinimi i procesit të likuidimit e cila kryhet nga ana e Ofruesit të Shërbimeve Profesionale në likuidim;
- Ndhmon Drejtorin Ekzekutiv në përmbylljen e punës së Agjencisë, duke koordinuar planin për transferimin e përgjegjësisë të mbetura të AKP-së në institucionet të cilat do të trashëgojnë punët e mbetura të Agjencisë;
- Ndhmon në zbatimin e ligjeve të aprovuara nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës, udhëzimeve administrative të aprovuara nga institucionet e Republikës së Kosovës të aplikueshme për AKP-në;
- Ndhmon në zbatimin e akteve nënligjore të AKP-së, vendimeve dhe udhëzimeve të Bordit të Drejtorëve në lidhje me proceset dhe detyrat e Agjencisë;
- Ndhmon në zbatimin e procedurave të shitjes dhe likuidimit të NSH-ve;
- Ndhmon në zbatimin e administrimit të Ndërmarrjeve Shoqërore sipas udhëzimeve të Drejtorit Ekzekutiv;
- Në koordinim të plotë me Drejtorin Ekzekutiv, mban lidhje me institucionet e Republikës së Kosovës, donatorët, dhe organizatat tjera relevante vendore e ndërkombëtare;
- Mban kontakte efektive me biznesin dhe institucionet financiare, institucionet ekonomike, media dhe shoqërinë civile për çështjet që ndërlidhen me procesin e likuidimit;
- Këshillon Drejtorin Ekzekutiv lidhur me komunikimin me palët e jashtme sa i përket çështjeve që ndërlidhen me sektorin e likuidimit dhe privatizimit/shitjes;
- Realizimin e detyrave të tjera të caktuara nga Drejtori Ekzekutiv, apo në raste edhe nga Bordi i Drejtorëve;



## 2. Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë, sipas nenit 9 të LZP-së

---

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

## 3. Kërkesat e përgjithshme formale

---

- **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 4 vite të studimeve; Diplomat nga universitetet e huaja duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.
- **Kualifikime të posaçme formale:** Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitat e kësaj klase;
- **Përvoja e punës së kërkuar:** Së paku tetë (8) vite përvojë pune profesionale, duke përfshirë së paku pesë (5) vite përvojë pune në pozita drejtuese. preferohet në fushat që lidhen me fushëveprimin e institucionit ku rekrutohen siç janë: ekonomi, financa, administrim biznesi, menaxhim, juridik, apo përvojë tjetër përkatëse



#### 4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

---

- Aftësi për të marrë vendime të vështira, nën presion dhe në përgjithësi të ketë aftësi dhe përvojë për të punuar në ambient të proceseve të ndërlikuara dhe aftësi të orientohet kah rezultatet;
- Shkathtësi të shkëlqyera strategjike dhe analitike që mundësojnë të këshilloj për çështje komplekse me besueshmëri dhe përcaktimin dhe arritjen e objektivave strategjike të institucionit.
- Aftësi për të udhëhequr bashkëpunimin dhe për të menaxhuar ndryshime të rëndësishme në organizata të mëdha dhe komplekse.
- Njohuri të gjera lidhur me fushën e përgjegjësisë së institucionit, menaxhimin e sistemit buxhetor dhe kontrollit të brendshëm ;
- Aftësi për t'iu përshtatur prioriteteve të ndryshuara, kërkesave dhe afateve kohore përmes aftësive të nivelit të lartë analitik dhe zgjidhjes së problemeve;
- Aftësi të forta negociimi, komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësinë për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie besimi me titullarin e institucionit dhe stafin që menaxhon.
- Aftësi të larta organizative, drejtuese (leadership), formulim politikash dhe menaxhim strategjik;
- Aftësi për të motivuar dhe mobilizuar personelin lidhur me misionin dhe qëllimet e organizatës;
- Të ketë integriteti të lartë moral dhe t'i përmbahet standardeve të larta të etikës;
- Njohuri të rrjedhshme në të folur dhe në të shkruar në gjuhët Shqipe apo Serbe. Njohja e gjuhës Angleze e preferuar;
- Aftësi për të punuar në mënyrë efektive në një mjedis multi-etnik dhe multikulturor;



## 5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

---

Aplikacioni i cili plotësohet online me rastin e aplikimit (konsiderohet si CV dhe vlerësohet nga Komisioni);

- Kopjet e diplomave mbi kualifikimin arsimor, nostrifikimin për diplomat e marra jashtë vendit;

Certifikatat e trajnimeve

- Dëshmi për përvojën e punës / vërtetim i lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozitë;
- Letër motivimi;
- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit;
- Kopjen e letërnjoftimit/Pasaportës;
- Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik
- Certifikatë nga Gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit si dhe
- çdo dokument që provon plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurrimit dhe të deklaruara në aplikacion.

## 6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

---

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për pranim do të shpallet më së largu deri më datën 04/03/2024, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net> )

## 7. Kriteret specifike shtesë

---

## 8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

---

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 30 pikë

## 9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

---

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 10. Mënyra e aplikimit

---

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)



## 11. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

---

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

### **Të dhëna shtesë:**

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

